



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.348/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur përshkak të parregullsive gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet Lokale 2017 të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt ankesa e Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë e datës 22.10.2017, e paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet Lokale 2017 të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me të cilën ka pretenduar se në shkollën 8 Marsi në Pejë në vendvotimin 1704X/03R ka munguar komisioneri i LVV-së Valon Azizi i cili ka pasur një rast të vdekjes, dhe se në munges të tij vëzhguesit i kanë zëvendësuar komisionarët duke qëndruar afër kutisë së votimit dhe dukur si nëse fletvotime votuesve.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e BIRN dhe Internews Kosova është e parregullt, sepse parashtruesi i ankesës nuk e ka përshkruar se kush është kryesi i supozuar në këtë rast por vetëm se e ka bërë një përshkrim të komisionerëve në vendvotimin 1704x/03R, dhe si tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.7 pika e) ku përcaktohet që në ankes duhet të ceket emri, adresa dhe informacionet e shkelësit të pretenduar.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL Anr.348/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.